

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"PARTNER-AL"**

Në bazë të ligjit Nr.7512 datë 10.08.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismes së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit" si dhe të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për shoqëritë tregtare", me vullnetin e tyre të lirë të shprehur në nënshkrimin e këtij Akti, sot më datë **01/09/2021**., Themeluesit:

- **Aldi Qose** , shtetas shqiptar i biri i Arqiles lindur ne Lushnje i datelindjes 12.10.1988, banues ne Tirane me nr Personal I81012021I
- **Blerta Sulaj** , shtetase shqiptare e bija e Petrefit lindur ne Vlore e datelindjes 16.04.1989, dhe banuese ne Tirane nr Personal I95416103L
- **Oni Lamçe**, shtetas shqiptar i biri i Fatmirit lindur ne Fier, i datelindjes 16.03.1999 dhe banues ne Tirane me nr Personal J90316058W

Deklaronë se ka vendosur të nënshkruaj këtë kontratë themelimi për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë referuar si Shoqëria), aktiviteti i së cilës rregullohet nga Akti i Themelimit dhe Statuti duke respektuar edhe kërkesat e legjislacionit shqiptar për shoqëritë tregtare

Neni 1-Emërtimi

Emërtimi i shoqërisë është **"PARTNER-AL" SH.P.K**

Ne të gjitha aktet e dokumentat që dalin nga shoqëria emertimi i saj do të paraprihet (ose do të ndiqet menjëherë) nga inicialet "SH.P.K" dhe nga shpallja e kapitalit themeltar.

Neni 2-Vëndndodhja e selisë

Shoqëria e ka selinë ne qytetin e Tiranës Njesia Bashkiake nr 5, Rruga Tish Daija, Kompleksi Haxhia, Shkalla 7,Kati 6, Ap nr 46.Zone Kadastrale 8260 Nr Pasurie 6/442+6-39

Neni 3- Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë do të jetë pa afat, duke filluar prej datës së regjistrimit të saj në Qendren Kombetare te Rregjistrimi.

Neni 4- Objekti i veprimtarisë

Objekti i shoqërisë është si më poshtë:

- Zhvillim dhe sherbime te burimeve njerezore,organizmim I trajnimeve dhe konsulence per menaxhimin e shitjeve,konsulence marketingu.Studime tregu.Sherbime dhe komisione ndermjetesimi,organizim eventesh,trajnime specifike sipas kerkesave te bizneseve.Vleresim performance per punonjesit



- Aktivitet ne patundshmerine i cili nuk eshte i kufizuar ne vleresimin e pasurive te pa tundshme, sherbime te vleresimit te pasurive te patundshme dhe te tundshme si dhe te pasurive te tjera, mallrave, sherbimeve, konsulence, sherbim dhe konsulence per hyrje ne treg.
- Komisjone ndermjetesimi
- Konsulence te burimeve njerezore
- Si dhe cdo aktivitet tjetër i konsideruar fitimprures per shoqerine

E gjithë veprimtaria e shoqerise, pavarësisht nga objekti i saj do te mbeshtetet ne licencat e leshuara per kete qellim nga organi kopetent shteteror

Kryerja e çdo operacioni ekonomik e juridik, prodhues dhe tregtar e financiar, që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e veprimtarisë së shoqërisë, për të cilin, ne baze te legjislacionit shqiptar, kërkohet leje e posaçme nga organet kompetente të administratës publike, do të realizohet vetëm pasi të jetë siguruar leja përkatëse.

Neni 5- Kapitali Themeltar

1) Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000(njeqindmije)lek

Pjesëmaria e themelueses ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributin e saj si me poshtme:

1. **Aldi Qose** , shtetas shqipetar i biri i **Arqiles** lindur ne **Lushnje** idatelindjes **12.10.1988**, banues ne **Tirane** ne **Rugen Teodor Keko** me nr **Personal I81012021I** Zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 51000 pesedhjetenjemije)lek qe perben 51% te kapitalit themeltar te shoqerise.
2. **Blerta Sulaj**, shtetase shqipetare e bija e **Petrefit** lindur ne **Vlore** e datelindjes **16.04.1989**, dhe banuese ne **Tirane** nr **Personal I95416103L** Zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 19000 (nentembdhjetmije)lek qe perben 19% te kapitalit themeltar te shoqerise
3. **Oni Lamçe**, shtetas shqipetar i biri i **Fatmirit** lindur ne **Fier**, i datelindjes **16.03.1999** dhe banues ne **Tirane** me nr **Personal J90316058W** Zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 30000 (tridhjetmije)lek qe perben 30% te kapitalit themeltar te shoqerise

Aksionari duhet te mbajne rreziqe (borxhet, detyrimet ligjore dhe financiare, etj) ne baze te perqindjes perkatese

Neni 6-Kontributet dhe pjesët e kapitalit themeltar

Sipas kontributeve në kapitalin themeltar të shoqërisë eshte vetem nje pjese e cila perben 100 % te kapitalit te shoqerise.

1. Kapitali i mesiperm eshte nenshkruar dhe shlyer teresisht ne lek nga ortakët e shoqerise

Kuota me vlere 51000 lek, qe perbene 51% te kapitalit themeltar te shoqerise, 19000 lek qe perbene 19% te kapitalit themeltar te shoqerise dhe 30000 lek qe perbene 30% te kapitalit themeltar te shoqerise

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të perfaqesohen nga letra me vlere të tregtueshme dhe as me kontribute në shtetë.

Ortaku pergjigjet për humbjet e shoqërisë perkundrejt të tretteve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë

Neni 7- Transferimi i pjesëve të kapitalit

1. Pjesët e kapitalit janë të transferueshme ndaj të tretteve sipas procedurave të parashikuara nga Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për shoqëritë tregtare" dhe nga statuti i shoqërisë.

Neni 8 - Administrimi

1. Shoqëria administrohet nga një ose disa administrator, qofshin këta edhe jo ortak, të cilët emërohen ose shkarkohen nga Asambleja e Zakonshme.
2. Administratori është përfaqësuesi ligjor i shoqërisë. Ai ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të trette, në interes të shoqërisë, dhe në emër të saj në të gjitha rrethanat që kanë lidhje me objektin e Shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji apo Statuti ja jep Asamblesë së Ortakëve.

3. Administratori i parë i shoqërisë është:

1. Z. Oni Lamç i biri i Fatmirit i datelindjes 16.03.1999 me nr Personal J90316058W caktohet si administrator i shoqërisë me afat 1 vjeçar i rinovueshem.
2. Të gjitha shpenzimet, taksat dhe honoraret e paguara për këtë akt dhe aktet që rrjedhin prej tij u përkasin bashkarisht dhe solidarisht nënshkruesëve në përpjestim me kontributet e tyre deri sa shoqëria të rregjistrohet në regjistrin tregtar.

Neni 9- Të tjera

1. Shoqëria do ta ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni - 10

1. Të gjitha kundërshtimet ose mosmarrveshjet që mund të lindin gjatë funksionimit të shoqërisë ose gjatë likuidimit të saj midis ortakëve ose një ose më shumë ortakëve dhe Shoqërisë do të diskutohen në menyre të drjetpëdrejtë midis të interesuarëve për ti zgjidhur me pajtim. Në rast të kundërt i nënshtrohen juridiksionit të gjykatave kompetente në kushtet e parashikuara nga legjislacioni Shqiptar në fuqi.

Neni - 11

1. Ky Akt Themelimi është përgatitur në katër kopje të barabarta dhe të barazvlefshme.

Parë dhe miratuar në Tirane , më 01/09/2021